



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226179
Datë: 08.12.2023
Numri i dokumentit: 05035426

C-IV-14-2101

Ankuesi

S D, fshati *L i P*, Podujevë, i përfaqësuar nga avokat *B I*, Prishtinë

Kundër

E paditura

NSH “FAN ZAHIR PAJAZITI”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, me 8 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET ankesa si e bazuar dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN106-0856 i datës 24 shkurt 2014, **ndryshohet**.

II. OBLIGOHET e paditura AKP, që ankuesit **S D** në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës, t’i paguaj **shumën prej 918.96 €** dhe në emër të interesit ligjor 10 % **shumën prej 99.81 €**, të cilat do të paguhen në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave, sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së (Ligji nr. 04/L-034).

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 28 mars 2014, i autorizuari i paditësit dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN106-0856 të datës 24 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për tri paga të papaguara nga NSH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim). Ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme Vendimin me nr. PRN-046-0806, të datës 24 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të papaguara në shumën prej 918.96 € për periudhën nga Janar 2006 deri Mars 2006.

Më tej, ankuesi për gjykatën ka dorëzuar :

- *Kopjen e listën së rrogave të mbetura borxh për ankuesin;*
- *Prokurën speciale për avokaturën “I A”, avokat B I.*
- *Kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datën 24 mars 2006;*
- *Kopje e librezës së punës;*

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka nxjerrë vendimin në fjalë duke u bazuar në nenin 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit parasheh që tri pagat e papaguara të punonjësve janë kërkesa prioritare dhe si të tilla kanë prioritet më të lartë. Megjithatë, ky nen nuk u njeh të gjithë punonjësve automatikisht të drejtën për tri paga, por i jep prioritet tri pagave që mund të kenë mbetur të papaguara nga totali i pagave që ndërmarrja nuk u ka paguar punonjësve.

Në çdo rast kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet me prova që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarrjes. Ky nen në vetvete nuk i njeh automatikisht të drejtën ndonjë punonjësi për kompensim të tri pagave. Tutje në vendim AKP-ja i referohet nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që: “...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:....kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”.

Kërkesa e parashtruesit u refuzua si e pavlefshme duke ju referuar nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut , nr. 1999/24, që parashikon që ‘pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet’.

Në bazë të dispozitave të mësipërme, sipas AKP-së kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja nuk ka arritur t’i përmbush obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Më 2 nëntor 2016, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 11 korrik 2014, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN106-0856 të datës 24 shkurt 2014.

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN106-0856 të datës 24 shkurt 2014.

Më 1 dhjetor 2016, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar përgjigjen në mbrojtje, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që padia e paditësit të konsiderohet si e bazuar pasi që me ndërprerjen e marrëdhënies së punës me anë të letër pezullimit, paditësi ka vepruar sipas udhëzimeve të AKM-së .

Më 12 dhjetor 2016, AKP-ja ka dorëzuar kundërpërgjigje ku ka kërkuar nga Gjykata që të refuzojë ankesën e paditësit si të pa bazuar pasi që sipas AKP-së njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës nuk përbën ndërprerje të parashkrimit

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t’i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;*
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;*
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;*
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;*
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;*

Sipas mbrojtjes së të paditurës, ankesa është e parashtruar me vonesë, por e paditura me asnjë dëshmi nuk ka provuar se ankuesi nuk ka respektuar afatin 30 ditor të përcaktuar më nenin 37.7 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në (Nr. 04/L-034).

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH FAN “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtor deri në momentin e privatizimit të NSH dhe se me njoftimin e datës 24 mars 2006 i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe me po të njëjtin njoftim edhe udhëzuar që për çdo kërkesë kreditore që mund të ketë do të shqyrtohet sipas procedurave të likuidimit dhe se do të kontaktohet kur te fillojnë këto procedura. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar dhe se njoftimi i datës 24 mars 2006 ka të bëjë vetëm dhe ekskluzivisht me krijimin e listës së shpërndarjes së 20 % të të ardhurave nga privatizimi i NSH. E paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës së ankuesit dhe as lartësinë e shumës së kërkuar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në kopjen e librezës së punës, njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe vërtetimin e lëshuar nga shërbimi financiar i ndërmarrjes, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune në NSH FAN “Zahir Pajaziti” nga data 17 prill 1987 deri më 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja. Poashtu, vërtetimi i datës 24 mars 2006 vërteton faktin se ankuesi kishte qenë punëtor i NSH deri në ditën e privatizimit dhe se me këtë letër ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH me datë 24 mars 2006.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante librezën e punës dhe njoftimin e datës 24 mars 2006 lëshuar nga vet AKP, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 918.96 € €, gjykata është bazuar në vërtetimin e shërbimit financiar të NSH lidhur me tri pagat e fundit për muajt janar, shkurt dhe mars 2006, nënshkruar

nga kryetari i sindikatës, drejtori financiar dhe drejtori i NSH. Nga vërtetimi i lartcekur vërtetohet fakti se ankuesi për tre muajt para privatizimit të NSH ka pranuar pagë bruto nga NSH në lartësi prej 306.32€. Po ashtu nga librezat e punës vërtetohet fakti se ankuesi kishte 19.07 vjet stazh pune në NSH. Andaj në bazë të Neni 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/ 19.07 vite të përvojës së punës në NSH ankuesit i takojnë 3 paga si dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe meqenëse lartësia e pagës së fundit ka qenë 306.32€, ankuesit i takon dëmshpërblimi në lartësi të përgjithshme prej 306.32€ (3 paga x 293.78 €), siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i drejtë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur prirje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund të ketë duhet të parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit.

Po ashtu, pretendimi i të paditurës se letra e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e datës 24 mars 2006, ka të bëjë vetëm dhe ekskluzivisht me krijimin e listës së shpërndarjes së 20 % të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes, nuk është i drejtë. Me njoftimin e lartcekur ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si pasojë e shtijës së aseteve të NSH si dhe është njoftuar se shumë-pagat që mund të jenë mbetur borgj mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Po ashtu ankuesi është njoftuar se kërkesat e tilla do të shqyrtohen në procedurë të likuidimit dhe do të kontaktohet kur të fillojnë këto procedura, andaj nga kjo nuk mund të vihet në përfundim se ky njoftim ka të bëjë vetëm me 20 %, siç pretendon e paditura.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata vie në përfundim se ankuesi S D, ishte punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se i takon e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën prej 99.81 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në diapozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi si palë e suksesshme nuk i ka kërkuar shpenzimet gjyqësore.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a

Manushe Karaçi